



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	19. 12. 2023	3 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	7494/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1291/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1291/2023 të datës 16.10.2023 të ankuesit me adresë banimi:

në
çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me A.nr.1291/2023, e datës 16.10.2023, e parashtruara nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me shifër:03-1-895/2023 i datës 16.10.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Ranillugut, ndërsa anulohet Konkursi me numër reference RN00012009, emri i grupit "Specialistë të Shkencave Shoqërore" për pozitën "Përkthyes shqip-anglisht-serbisht" i shpallur me datë 06.07.2023, nga Komuna Ranillugë, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë rekrutimi.

III. Obligohet Kryetari i Komunës Ranillugë që të ndërmerret të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, të gjitha këto në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi (tutje referuar ankuesi), me datë 16.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1291/2023, kundër Vendimit të datës 16.10.2023, të Komisionit të pranimit, me pretendimet se ankimore se diplomat e kundër kandidatit janë të panostrifikuara pasi që janë lëshuar nga shteti i Serbisë, si dhe pretendon se i njëjti pavarësisht faktit se ka pasur certifikata që dëshmojnë njohjen e gjuhës serbe dhe angleze, mirëpo serish është vlerësuar më pakë se kandidati i suksesshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 24.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Ranillgut, ndërsa, Këshilli me datë 27.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6553/2023 të datës 16.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 16.10.2023 dërguar nga ankuesi për Këshillin; Vendimin me shifër:03-1-894/2023 i datës 16.10.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Ranillgut; Konkursin e datës 06.07.2023; Ankesa e ankuesit e parashtruar në Komisionin e Pranimit; Formularin e Renditjes përfundimtare i datës 09.10.2023; Njoftimin e datës 21.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.10.2023; Vendimin për Themelimin e Komisionit të Pranimit të datës 27.09.2023; Listën e aplikantëve; Shkresë e datës 17.08.2023; Shkresën e datës 21.08.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 12.08.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e a datës 12.08.2023 të kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur Aplikacionin e a datës 31.07.2023 të kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Formularët e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve dhe pikëve të përgjithshme; Vendimin me shifër:03-1-895/2023 i datës 16.10.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Ranillgut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komuna e Ranillgut, me datë 06.07.2023, ka shpallur konkursin e jashtëm-pranim, me numër të referencës RN00012009, emri i grupit "Specialistë të Shkencave Shoqërore " pozita e punës "Përkthyes Shqip-anglisht-serbisht" , Klasa " Profesional 2", numri i kërkuar një (1 vend pune), në kuadër të Drejtorisë për Administratë dhe Personel, në të cilin konkurs vërtetohet fakti se ka aplikuar edhe ankuesi më datë 12.08.2023.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi i është nënshtruara fazave të procedurës së rekrutimit, kurse sipas Formularit të renditjes përfundimtare të datës 09.10.2023 ankuesi ka arritur të grumbulloi 78.6 pikë, ndërsa kundër kandidati i tij ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 86.4 pikë. Tutje, ankuesi i pakënaqur me rezultatin përfundimtar me datë 10.10.2023 ka parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Komisionit të Pranimit të Komunës së Ranillgut përmes Vendimit të datës 16.10.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi rezultatet e vlerësimit.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtues që ka të bëjë me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e në mbështetje të dispozitave të nenit 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*, ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër të referencës RN00012009, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë, dhe ka konstatuar se tek kërkesa të përgjithshme të nevojshme e ka përcaktuar që kërkohet: *"Diplomë universitare në fushën e administratës publike 240 pikë"* edhe pse kjo pjesë potencohet tek pjesa e kërkesave të përgjithshme formale, ndërsa tek pjesa kërkesave të përgjithshme formale ka kërkuar si në vijim: *"Njohuri specifike profesionale në fushën përkatëse të punës, të marra përmes arsimit bazë dhe trajnimeve - Njohja e metodave standarde të kërkimit që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe analitike në vendimmarrje dhe procedura administrative/teknike në një fushë specifike - Aftësi të mira komunikuese, duke përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe aftësi për t'i përcjellë ato - Njohuri të punës në kompjuter në aplikacionet softuerike - Ëord, Excel, Poëer Point"*

Kolegji i Këshillit me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara ligjit material, ka analizuar Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.1/7, pasi që lidhur me klasën **Profesional 2**, kërkesat e përgjithshme formale janë të përcaktuara si në vijim: a) *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK); b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës"* ndërlidhur me Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm ku për grupin nën renditjen 14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore kërkohet kualifikimi në fushën arsimit: *"Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi"* dhe ka ardhur në përfundimin se shpallja e konkursit të datës 06.07.2023 me numër referencës RN00012009, emri i grupit *"Specialistë të Shkencave Shoqërore"* pozita e punës *"Përkthyes Shqip-anglisht-serbisht"*, Klasa *"Profesional 2"* është zhvilluar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase me rastin e shpalljes së konkursin fushën e arsimit e kanë kufizuar vetëm në *Diplomë universitare në fushën e administratës publike 240 pikë*, e që dispozitat e rregullores si më lartë nuk kanë përcaktuar diplomë me 240 kredi/pikë, madje as fusha e arsimit nuk është e përcaktuar në administratë publike, sikurse në rastet kur kemi të bëjmë me pozita të cilat për nga klasa janë Profesional 2, njëri nga kriteret e përgjithshme formale është edhe *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*, kurse në konkursin e kontestuar ky kriter është anashkalua.

Andaj, pas konstatimit si me lartë së akti i shpalljes së konkursit është i përfshire më shkelje esenciale të dispozitave ligjore për Shërbimin Civil, respektivisht shkelje të kritereve formale të përcaktuara sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet ankimore të ankuesit, ngase të gjeturat e tjera eventuale nuk do të kishin asnjë relevancë juridike në këtë procedurë, për faktin së me konkursin e shpallur të datës 06.07.2023, janë përcaktuara kritere shtesë lidhur me fushën e arsimimit dhe kredive të diplomës, ndërsa lidhur me përvojën e punës janë anashkaluar, e të cilat kërkesa kanë pamundësuar konkurrimin apo përzgjedhjen eventuale të kandidatëve të tjerë potencial të cilët nuk e kanë pas fushën e kualifikimit arsimor në administratës publike.



Siç u tha me sipër, dhe duke qenë se shpallja e Konkursit për pranim, me numër reference RN00012009, emri i grupit "Specialistë të Shkencave Shoqërore" pozita e punës "Përkthyes Shqip-anglisht-serbisht", Klasa " Profesional 2", është përcjell me shkelje ligjore të specifikuar si me lart, Kolegji i Këshillit në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së një procedurë e përcjell me shkelje procedurale konsiderohet si e paligjshme, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji vendosi që konkursi me numër të reference RN00012009 të anulohet në tërësi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm mbi bazën e të gjeturave si më lart kurse konkursi si në fjalë dhe vendimin i kontestuar janë anuluar, gjegjësisht shfuqizuar si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1291/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ranillugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ranillugut,
- Arkivit të KPMSHCK-së.